



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 33, datë 25.06.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PËR OBJEKTIN:
“INFRASTRUKTURA INXHINIERIKE PËR “GREEN COAST 2” LOTI 4/1 PALASË,
BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Green Coast” sh.p.k, “Aqua Marin” sh.p.k, “I&G” sh.p.k, “Devis Construction” sh.p.k, “Edonil Konstruksion” sh.p.k, “Shamo Construction” sh.p.k, “Klais” sh.p.k, “Seaside Hospitality” sh.p.k, “Seaside Hotel” sh.p.k, “Seaside Hotel II” sh.p.k, “Seaside Entertainment” sh.p.k, “Seaside Residence I” sh.p.k, “Seaside Residence II” sh.p.k, “Seaside Residence III” sh.p.k, “Seaside Residence IV” sh.p.k, dhe “Seaside Residence V” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës për objektin: “Infrastruktura inxhinierike për “Green Coast 2” Loti 4/1 Palasë, Bashkia Himarë”, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Green Coast” sh.p.k, “Aqua Marin” sh.p.k, “I&G” sh.p.k, “Devis Construction” sh.p.k, “Edonil Konstruksion” sh.p.k, “Shamo Construction” sh.p.k, “Klais” sh.p.k, “Seaside Hospitality” sh.p.k, “Seaside Hotel” sh.p.k, “Seaside Hotel II” sh.p.k, “Seaside Entertainment” sh.p.k, “Seaside Residence I” sh.p.k, “Seaside Residence II” sh.p.k, “Seaside Residence III” sh.p.k, “Seaside Residence IV” sh.p.k, dhe “Seaside Residence V” sh.p.k,
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.





4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDDI RAMA

MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 11 /02/ 2026